REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2021-2024", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2021-2024", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Ilir Rusi***: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të diskutimeve të patura, dhe për shkak të krijimit të kuorumit, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor zonja Llagami për shkaqe objektive nuk mund të marrë pjesë. Gjithashtu edhe për shkaqe shëndetësore nuk mund të jetë prezent zoti Tabaku në mbledhje, por është online. Është e konfirmuar nga ana e administratës që është në lidhje online. Pra do kemi një mbledhje hibride me prezencën në sallë në mbledhje plenare dhe me prezencë online.

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur. Për më tej, keni diskutime mbi rendin e ditës?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë me pikën e parë të tij që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2021-2024", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

***Klodian Kurushi***: Faleminderit zoti Rusi!

Sot përpara Këshillit paraqesim projektvendimin dhe relacionin që unë do ta lexoj përpara jush, që ka për objekt shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024. Bëhet fjalë për gjyqtarët të cilët janë diplomuar në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës dhe pas diplomimit në kemi përfunduar procesin e kualifikimit të tyre dhe kemi marrë vendimin për emërimin e tyre si magjistrat.

Sot ne paraqesim relacionin e radhës që ka të bëjë me hapjen e pozicioneve të lira në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm dhe një vend i lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnje, vende të lira të cilat duhet t'i përzgjedhin më pas kandidatët magjistratë që janë të renditur sipas listës së diplomimit paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës në bazë të rezultateve që ato kanë arritur gjatë viteve akademike 2021 – 2024.

Po filloj shkurtimisht të bëj relatimin e relacionit.

Me shkresën nr. 3499 prot., datë 03.07.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 34, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Shkolla e Magjistraturës, në vijim të ushtrimit të funksioneve dhe veprimtarisë së saj, ka përcjellë listën e kandidatëve të diplomuar për magjistratë, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2023-2024, gjithsej 32 (tridhjetë e dy) kandidatë.

Për këtë shkak Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatiti projektvendimin "Për shpalljen e pozicioneve të lira për të emëruarit më datë 31.07.2024, të diplomuar në përfundim të programit të formimit fillestar 2021-2024".

Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet fillimisht shpallja e pozicioneve të

lira të të diplomuarve në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2021-2024.

Në pikën e 2 të projektvendimit përcaktohen pozicionet e lira në gjykatat përkatëse, ku në total janë parashikuar 32 (tridhjetë e dy) pozicione të lira, pra sipas numrit të të emëruarve me vendimin e datës 31.07.2024.

Lidhur me përcaktimin e një numri të tillë pozicionesh të lira është mbajtur në konsideratë përcaktimi i bërë në nenin 25, pika 2, e Ligjit nr. 48/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit "Për shpalljen e pozicioneve të lira për kandidatët për magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në çdo rast, këshillat vlerësojnë mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë dhe, në veçanti, nevojat urgjente të gjykatave dhe prokurorive në këndvështrimin e funksionalitetit të tyre". Pikërisht, referuar kësaj dispozite, por edhe në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, shkronja "a" dhe të nenit 90, të Ligjit nr. 98/2016 sipas pikës 2 të projektvendimit të propozuar janë përcaktuar në total 32 (tridhjetë e dy) pozicione të lira, që i korrespondon numrit të gjyqtarëve të emëruar me vendimin e datës 31.07.2024. Në këtë rast mbahen në konsideratë: i) pozicionet e lira në tërësi në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atë administrativ, në kuptimin e plotësimit pikërisht të atyre pozicioneve që paraqesin nevoja urgjente në pikëpamje të funksionalitetit aktual të këtyre gjykatave, ii) por edhe në një të ardhme të afërt referuar projeksioneve për mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë, dhe në këtë rast, ne, duke iu referuar këtij propozimi dhe konstatimi, si shembull marrim Gjykatën e Fierit në të cilën parashikohet të bëhet edhe një vakancë e lirë për shkak të një vendimi të mundshëm që presim nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Ndërsa në Vlorë mund të parashikohen 3 gjyqtarë për shkak se njëri nga gjyqtarët aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, mbush moshën për pension në muajin janar të vitit 2025.

Sa i përket pozicioneve të lira të shpallura është mbajtur në konsideratë gjithashtu: i) numri i pozicioneve të lira në secilën nga gjykatat që paraqesin nevoja urgjente në pikëpamje të funksionalitetit aktual të tyre; ii) madhësinë e gjykatave; iii) distancën fizike e tyre në raport me kryeqytetin.

Ky relacion shoqërohet gjithashtu edhe me një informacion mbi gjendjen e sistemit gjyqësor lidhur me vakancat, si edhe me ngarkesën respektive të gjyqtarëve.

Në mënyrë tabelare, sipas treguesve si më poshtë, ne parashtrojmë propozimet tona:

Gjykata Berat ne propozojmë të shpallen dy vakanca të lira, pra dy vende të lira – organika është 8, në detyrë janë 3, ngarkesa e gjykatës është 1173;

Gjykata Dibër (nuk po e them gjithmonë "e juridiksionit të përgjithshëm shkalla e parë", por po vijoj vetëm me emrat e qyteteve) parashikimi është 3, pra ne propozojmë 3 pozicione të lira – organika është 7, në detyrë janë 4, ngarkesa është 563 çështje për gjyqtar;

Elbasan, parashikimi në propozim është për 2 vende të lira të hapura – organika është 18, në detyrë janë 10 dhe ngarkesa për secilin gjyqtar është 4392;

Fieri, propozimi është 5 – organika në këtë rast në Fier është 21, në detyrë janë 12, ngarkesa për secilin gjyqtar është 2413 në total;

Gjirokastër, propozimi ynë është për 2 vakanca të lira – organika është 7, në detyrë aktualisht janë 2 dhe ngarkesa për gjyqtar në total është 1190 çështje;

Korça, propozojmë 4 gjyqtarë, pra 4 vende të lira për katër gjyqtarë që janë të emëruar – organika është 15, në detyrë aktualisht janë 7 gjyqtarë dhe ngarkesa e gjykatës është 2086 çështje.

Kukësi, parashikimi është 2 gjyqtarë (2 vende të lira) – organika është 7 gjyqtarë në total, në detyrë aktualisht ushtrojnë funksionin 5 gjyqtarë dhe ngarkesa në Gjykatën e Kukësit është 575 çështje në total;

Lezha, ne propozojmë 2 vende të lira, pra 2 pozicione të lira – organika është 11, në detyrë janë 7 dhe ngarkesa në total është 1746 çështje;

Saranda, propozojmë 2 vende të lira – organika është 7, në detyrë janë 5 dhe ngarkesa në të gjithë gjykatën është 1140 çështje;

Shkodër, ne propozojmë të hapen 4 pozicione të lira – organika është 15 gjyqtarë, në detyrë janë 6 gjyqtarë, ngarkesa 1680 çështje;

Vlora, ne propozojmë 3 gjyqtarë – numri i gjyqtarëve është 16, në detyrë janë 9 dhe ngarkesa është 2299 çështje. Dua të bëj një koment për Vlorën pse propozojmë 3. Këshilli në këtë situatë, mund të ketë në konsideratë dy alternativa. Alternativa e parë

mbajtur në vëmendje janë organikat dhe ngarkesat e gjykatave... propozohen që të hapen 5 vende në Fier dhe 3 në Vlorë. Pra janë dy vende të lira në Vlorë dhe vendi i 3-të në Vlorë zyrtarisht bëhet vakancë e përhershme në janar të vitit 2025 për shkak të moshës së pensionit dhe një vendimi të mundshëm që mund të merret për një nga magjistratët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Ndërsa kemi edhe alternativën, vendi i 6-të në Fier bëhet vakancë e përhershme në datë 23.10.2024. Bëhet vakancë e përhershme për shkak të pritshmërisë së një vendimi që mund të marri Kolegji i Posaçëm i Apelimit, pasi është shpallur data. Ngarkesa në Vlorë rezulton të jetë më e lartë referuar organikës dhe për rrjedhojë propozimi sipas variantit tonë është 5 të ketë Fieri dhe 3 të ketë Vlora. Pra jo në variantin 6 me 2, 6 Fieri dhe 2 Vlora. Mund të shkojë 6 Fieri, e thamë, sepse presim më datë 23.10.2024 si mundësi presim vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për një magjistrat. Njëkohësisht Fieri ka edhe situatën që një gjyqtar i Gjykatës së Fierit paguhet nga Gjykata e Tiranës, është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Tiranës dhe pagesën e bën nga Gjykata e Tiranës, por ka edhe 2 gjyqtarë të Gjykatës së Fierit që aktualisht janë të komanduar një në KLGJ dhe një në Gjykatën e Lartë. Kështu që mundësia e pagesës dhe e pritshmërisë... kështu që në këtë pikë janë tre që paguhen aktualisht jo nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, por kemi edhe pritshmëritë që thashë më sipër për një vend që mund të bëhet vakancë, ndërkohë presim edhe pjesën e situatës së transferimeve. Por aktualisht mendojmë që raporti 5 me 3 është më i shëndetshëm dhe më i kënaqshëm për të gjithë sistemin sepse duke iu referuar edhe ngarkesës së Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka një ngarkesë më të lartë për secilin gjyqtar, duke i çuar 3 Gjykatës së Vlorës, ulim edhe ngarkesën e gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Ndërsa Fieri e ka më të stabilizuar ngarkesën pasi ka më tepër gjyqtarë në organikë dhe që ushtrojnë aktualisht funksionet. Gjykata e Fierit ka më tepër gjyqtarë sesa Gjykata e Vlorës. Kjo është arsyeja pse ne propozojmë 5 në Fier dhe 3 në Vlorë. Ndërkohë që kemi të sigurt që një vend do hapet në janar të vitit 2025.

Kam edhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, propozojmë hapjen e një vendi të lirë. Gjithsej ata janë në organikë 9 gjyqtarë, 5 janë në detyrë dhe ngarkesa e punës në çështje që ata gjykojnë si gjykatë është 1833 çështje.

Në pikën 3 të projektvendimit, parashikohet e drejta e të emëruarve, referuar pikës 3 të nenit 35, si dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 36, të Ligjit nr.96/2016 për të përcaktuar, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të projektvendimit, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

Në pikën 4 të projektvendimit, parashikohet detyrimi i të emëruarve, referuar nenit 8 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për deklarimin e situatës së papajtueshmërisë ambientale sipas parashikimeve të pikës 3 të kësaj dispozite ligjore.

Më tej, në pikën 5 të projektvendimit parashikohet afati i aplikimit nga të emëruarit, afat ky që është përcaktuar... ne si Komision propozojmë ditën e nesërme, pra t'i lëmë një afat afërsisht 24 orësh, pra themi datë 02.10.2024, ora 13:00. Meqenëse ne e kemi shënuar 12 në projektvendim, por mbledhja fillon në orën 13:00 dhe e kemi bërë dje projektvendimin, duke menduar se përfundonte afati 24 orë në orën 12:00. Tani po e riformuloje dhe një herë propozimin: Data 2 dhjetor 2024, më falni, 2 tetor 2024, ora 13:00. Pra deri në orën 13:00 presim kërkesat dhe aplikimet për përzgjedhjen e preferencave nga gjyqtarët e emëruar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 31.07.2024.

Në këtë pikë të projektvendimit është përcaktuar edhe se mungesa e aplikimit, pra mungesa e preferencës së shprehur nga ana e të emëruarve, nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit të tyre në pozicion.

Në pikën 6 të projektvendimit përcaktohen dokumentet që të emëruarit duhet të dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) Një deklaratë me shkrim ku përcaktohen, sipas renditjes preferenciale, tri gjykatat nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkohen që të caktohen; ii) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarohet nëse ndodhen apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Së fundmi, në projektvendim përcaktohet edhe hyrja në fuqi e menjëhershme e tij dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Këto janë propozimet që ne kemi bërë për vendet e lira të shpallura me qëllim caktimin në pozicion të magjistratëve.

***Ilir Rusi***: Atëherë, ju lutem, ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse duhet plotësuar 24 orëshi i të drejtës së përzgjedhjes së tyre, besoj se propozimi do shkojë drejt orës 13:30.

Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime edhe një herë për orën?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord. (e ripërsërit)

Vendim "Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2021-2024".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 31.07.2024.

2. Pozicionet e lira janë si më poshtë:

i) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;

ii) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

iii) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

iv) pesë pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

v) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër;

vi) katër pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë ë Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

vii) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;

viii) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

ix) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

x) katër pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

xi) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;

xii) një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

3. Të emëruarit gjyqtarë në përfundim të programit të formimit fillestar 2021-2024 kanë të drejtë të përzgjedhin, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

4. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

5. Afati i aplikimit është deri më datë 02.10.2024, ora 13:30. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.

6. Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente:

i) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet.

ii) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*      *      *

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

***Ridvan Hado***: Faleminderit!

Me vendimin nr.323, datë 03.07.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur kualifikimi dhe lejimi i kandidates {...} për ndjekjen e Programit të Formimit

Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

Zonja {...} ka përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në vitin e sipërcituar. Me vendimin nr. 29, datë 30.07.2024, "Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar", Shkolla e Magjistraturës e ka vlerësuar kandidaten znj. {...}, me 80.18 pikë.

Gjithashtu ka rezultuar se sipas vendimit nr. 424/2020 Këshilli ka përcaktuar se për kandidatët të cilët kanë ndjekur programin e formimit fillestar, do të pranohen në shërbimin civil nëse plotësojnë kushtin e kalimit me sukses të këtij programi në Shkollën e Magjistraturës.

Ka rezultuar se zonja {...}, në referim të nenit 55/1 të ligjit nr. 98/2016, dhe nenit 21 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, plotëson kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor.

Sa më sipër, i propozoj mbledhjes, duke qenë se konstatohet se zonja {...} plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunës civil gjyqësor në kategorinë e ndihmësit ligjor; është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, sipas vendimit të KLGJ-së nr. 323, datë 03.07.2024, "Për kualifikimin e kandidates fituese për në Programin e Formimit Fillestar, profili ndihmës ligjor"; ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024, e ka vlerësuar kandidaten znj. {...}, me 80.18 pikë, çmojmë se duhet të kualifikohet për vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Faleminderit z. Hado!

(Pas 6 minuta shkëputjeje.)

Ndjesë sepse infrastruktura teknologjike është kjo që është dhe ndonjëherë ka edhe situata teknike. Kështu që rifillojmë komunikimin me të tretët.

Faleminderit zoti Hado në lidhje me çfarë prezantuat.

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Pro.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

*  *  *

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

***Ridvan Hado***: Faleminderit!

Me vendimin nr. 359, datë 11.07.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur kualifikimin dhe lejimin për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së

Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, për kandidaten fituese znj. {...}.

Zonja {...} ka përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në vitin akademik të sipërcituar në Shkollën e Magjistraturës e cila me vendimin nr. 29, datë 30.07.2024, e ka vlerësuar kandidaten znj. {...}, me 79.19 pikë.

Po ashtu zonja {...}, në referim të nenit 55/1 të ligjit nr. 98/2016, si dhe nenit 21 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, plotëson kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, pasi është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, me vendimin e KLGJ-së nr. 359, datë 11.07.2024, ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin për nëpunës gjyqësor, në kategorinë e ndihmësit ligjor. Ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës e cila me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024 e ka vlerësuar zonjën {...} me 79.19 pikë. Sa më sipër çmojmë se duhet të kualifikohet për vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Dakord.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi kualifikimin për emërim dhe vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

*     *     *

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***
***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

4.Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

***Ridvan Hado***: Faleminderit!

Me vendimin nr. 325, datë 03.07.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur kualifikimin dhe lejimin për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së

Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, për kandidatin fituese z. {...}, në profilin e ndihmësit ligjor.

Zoti {...} ka përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në vitin e sipërcituar dhe me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024, Shkolla e Magjistraturës, në përfundim, e ka vlerësuar kandidatin z. {...}, me 85.68. pikë.

Gjithashtu zoti {...}, në referim të pikës 1, të nenit 55 të ligjit nr. 98/2016, si dhe të nenit 21 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", plotëson kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor. Po ashtu është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës sipas vendimit të KLGJ-së nr. 325, datë 03.07.2024. Ka përfunduar me sukses, siç thamë më lartë, Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj 29, datë 30.07.2024 e ka vlerësuar zotin {...} me 85.68 pikë. Në këto kushte, i propozojmë mbledhjes plenare se duhet të kualifikohet zoti {...} për vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Dakord.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Yllka Rupa).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Yllka Rupa).

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores znj. Rupa.

***Yllka Rupa***: Faleminderit!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, konstaton për zonjën {...} se plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civilë gjyqësorë, në kategorinë "ndihmës ligjor". Është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës sipas vendimit të Këshillit, nr. 326, datë

03.07.2024, për kualifikimin e kandidates fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor. Gjithashtu ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës e cila me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024, për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjorë në Programin e Formimit Fillestar, ka vlerësuar kandidaten me 77,91 pikë.

Në këto kushte i propozojmë Këshillit emërimin e ndihmëse {...} në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Faleminderit znj. Rupa!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Pro.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

*          *          *

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt****:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Yllka Rupa).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Yllka Rupa).

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Fjala për relatoren znj. Rupa.

***Yllka Rupa***: Atëherë, edhe në lidhje me z. {...}, Komisioni konstaton se plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civilë gjyqësorë, në kategorinë "ndihmës ligjor". Është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës sipas vendimit të Këshillit, nr. 469, datë 31.07.2024, për

kualifikimin e kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, si dhe ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024, për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjorë në Programin e Formimit Fillestar, ka vlerësuar z. {...} me 77,30 pikë.

Në këto kushte i propozojmë Këshillit, kualifikimin dhe vijimin e procedurës për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin ndihmës ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatës së apelit.

***Ilir Rusi***: Faleminderit!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Dakord.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

*        *        *

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Yllka Rupa).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Yllka Rupa).

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjala për relatoren znj. Rupa.

***Yllka Rupa***: Atëherë, edhe në lidhje me znj. {...}, Komisioni konstaton se plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civilë gjyqësorë, në kategorinë "ndihmës ligjor". Është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës sipas vendimit të Këshillit, nr. 324, datë 0..07.2024, për

kualifikimin e kandidates fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, si dhe ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024, për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjorë në Programin e Formimit Fillestar, ka vlerësuar kandidaten {...} me 81,95 pikë.

Në këto kushte Komisioni i propozon Këshillit, vijimin e procedurës për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin ndihmës ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Faleminderit!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Dakord. (mezi dëgjohet vota).

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

*  *  *

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***
***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt****:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku.)

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku.)

Vijon çështja e radhës "Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjala për relatoren znj. Plaku.

***Ilir Rusi***: Për më tej, fjala relatores znj. Plaku.

***Irena Plaku***: Atëherë, faleminderit!

Po ju parashtroj edhe një herë, duke qenë se s'kisha hapur mikrofonin, relacionin për projektvendimin "Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar".

Në datën 20.09.2024, znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka paraqitur një kërkesë për dhënie leje për kualifikim dhe specializim profesional, për periudhën 05.10.2024 deri në datë 29.10.2024. Në kërkesën me shkrim parashtron se është nominuar për të marrë pjesë në

Programin e Lidershipit të Vizitorëve Ndërkombëtarë, program për të cilin është nominuar dhe titullohet “Rule of law and the U.S. Judicial System II” (Programi i Lidershipit të Vizitorëve Ndërkombëtarë). Është sponsorizuar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky program zhvillohet nga data 07.10.2024-25.10.2024. Nisja për në SHBA është planifikuar për në datën 05.10.2024 dhe kthimi në datën 29.10.2024.

Gjyqtarja ka relatuar se gjatë kësaj periudhe nuk ka planifikuar seanca gjyqësore, përveç datës 10.10.2024 dhe gjithashtu ka relatuar se kjo veprimtari nuk do ndikojë në përmbushjen e detyrave të saj në punë.

Lidhur me lejet e papaguara në nenin 24 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se magjistrati mund të përfitojë leje prindërore ose pushime të tjera. Në këtë nen parashikohen disa kritere për dhënien e lejes së papaguar. Sa i përket lejes së papaguar që jepet nga Këshilli në nenin 24 parashikohet se mund të jepet leje prindërore, leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimin vazhdues dhe leje për arsye familjare.

Në rastin konkret, zonja {...} ka paraqitur një leje për kualifimim dhe specializim, parashikuar në pikën 6, të vendimit nr. 72 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në rastin konkret, rregullorja parashikon që duhet të paraqitet para 30 ditëve. Në rastin konkret ky afat nuk është respektuar edhe për arsye se gjyqtarja është nominuar për të marrë pjesë në këtë program në datë 9, pra më pak se periudha 30-ditore. Në këto kushte ka qenë në pamundësi për të respektuar afatin 30 ditë përpara fillimit të lejes.

Kërkesa duhet të përmbajë me shkrim arsyet. Gjyqtarja ka relatuar arsyet për të cilën kërkon leje për të marrë pjesë në këtë program. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacion. Gjithashtu gjyqtarja ka paraqitur përveç kërkesës së lejes së papaguar edhe të dhënat lidhur me ngarkesën e saj. Gjithashtu është marrë informacion edhe tek zëvendëskryetari i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i cili ka thënë se për sa i përket kërkesës së zonjës {...} për lejen e papaguar, për arsye specializimi, ka relatuar se nuk cenohet funksionaliteti i gjykatës.

Lidhur me ngarkesën ka rezultuar se gjyqtarja ka aktualisht ka 558 çështje në gjykim;

Leja e kërkuar nuk e kalon afatin 2-vjeçar;

Kualifikimi të mos ketë mospërputhje me funksionin. Nuk rezulton që të ketë mospërputhje me pozicionin e saj.

Referuar sa më sipër KVEP-ja i ka propozuar mbledhjes plenare miratimin e kërkesës së {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, nga data 05.10.2024 deri në datën 29.10.2024.

Përjashtimin tërësisht nga shorti i gjyqtares {...}, gjatë periudhës së lejes së papaguar.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Gjithashtu parashikohet edhe njoftimi i këtij vendimi.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Dakord.

(e mbyll mikrofonin shpejt znj. Muçi).

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

*    *    *

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 9 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Gentiana Muçaj).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

*10. Emona Muçi (anëtare)*

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***5. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***6. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Gentiana Muçaj).

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej fjalën relatores znj. Muçaj.

***Gentiana Muçaj***: Me vendimin nr. 357, datë 11.07.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 97, datë 29.02.2024 "Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe vijimin e shqyrtimit të tij".

Sa më sipër propozohet caktimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...} duke njoftuar rregullisht palët në zbatim të parashikimeve të nenit 138 të ligjit "Për statusin". Për caktimin e seancës dëgjimore Këshilli duhet të mbajë në konsideratë afatin 15-ditor të njoftimit të palëve sipas parashikimeve të nenit 138, dhe seanca dëgjimore propozohet të bëhet në datën 16.10.2024, ora 12:00.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Atëherë, në vijim të procedurave, u la e njëjta datë për të cilën kemi lënë edhe për z. {...}, si seancë dëgjimore. Për efektivitet të punëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor përgjatë mbledhjeve plenare, pra 16.10.2024, ora 12:00, seanca dëgjimore.

Keni diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit përkatës, të përditësuar edhe me propozimin e relatores në lidhje me mbajtjen e seancës dëgjimore.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Dakord.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Dakord.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e datës 16.10.2024, ora 12:00 si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

*          *          *

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***
***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 01.10.2024)***

***Pika 10 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:03 dhe mbaroi në orën 14:18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Gentiana Muçaj*** ***(anëtare)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Bledar Bajri*** ***(anëtar)***
7. ***Albens Tabaku**** ***(anëtar)***
8. ***Markelian Koça*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***
10. ***Emona Muçi*** ***(anëtare)***

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Naureda Llagami***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Etrita Petriti, Drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.***

***3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***

***5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.***

***6. Edmond Hoxhaj, Birn.***

***7. Staf nga administrata e KLGJ-së.***

**RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit "Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Ilir Rusi***: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që është pika e fundit e kësaj mbledhjeje, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Ftoj Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, znj. Petriti për të bërë relatimin përkatës.

***Ilir Rusi***: Në vijim, znj. Etrita nuk ke ndezur mikrofonin.

Kështu që ju lutem për sa thatë deri tani, vazhdoni edhe një herë t'i thoni.

***Etrita Petriti***: Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, është organi kompetent për publikimin dhe shpalljen e konkurrimit të hapur për vendet e lira, në shërbimin civil gjyqësor.

Referuar ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar, parashikon se: “Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor, është Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

Me vendimin nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi krijimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor, si pjesë e strukturës së gjykatave të apelit, me përbërje referuar këtij vendimi.

Me vendimin nr. 586, datë 20.11.2020 KLGJ shpalli vendet vakante në pozicionet e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit dhe u shpallën më konkretisht vendet vakante referuar vendimit të cituar.

Këto vakanca u përmbushën përkohësisht nga të diplomuarit ndihmësligjorë në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019-2020 (8 pozicione) dhe nga ndihmësit ligjorë të gjykatave administrative të Shkallës së parë (9 pozicione).

Me vendimin nr. 214, datë 16.06.2022 të KLGJ-së “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit” u shpallën pozicionet vakante referuar këtij vendimi, të cilat u plotësuan tre pozicione me të diplomuar ndihmës ligjorë nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2020-2021.

Më pas me vendimin nr. 504, datë 28.09.2023 “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, u shpallën vendet vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor referuar vendimit të cituar, të cilat u plotësuan dy pozicione nga të diplomuar ndihmës ligjorë në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2022-2023.

Në vijim me vendimin 718, datë 06.12.2023 “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, u shpallën pozicione vakante referuar vendimit të cituar, të cilat u plotësuan një pozicion me ndihmës ligjorë të diplomuar në vitin 2022-2023.

Në vitin 2024 janë diplomuar 6 ndihmës ligjorë, konkretisht z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, {...} dhe {...}. (radhitur edhe sipas pikëve të përcjella zyrtarisht nga Shkolla e Magjistraturës).

Në një analizë të gjykatave të apelit, konstatojmë se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas strukturës, pas miratimit të hartës, ka 32 pozicione, në fakt 20 dhe vakanca 12.

Gjykata e Posaçme e Apelit 6 sipas strukturës, 3 sipas organikës në fakt, dhe 3 pozicione vakante.

Gjykata Administrative e Apelit 13 pozicione sipas strukturës, 9 pozicione në fakt dhe 4 pozicione vakante.

Duke analizuar gjithashtu edhe çështjet në shqyrtim, rezulton informacion i marrë nga strukturat kompetente: - Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm aktualisht ka 39.808 çështje në shqyrtim. - Gjykata Administrative e Apelit – 23.384 çështje në shqyrtim.

Në këto kushte, propozohet shpallja e 6 (gjashtë) vendeve vakante të pozicionit të ndihmësit ligjor pranë gjykatave të apelit, si më poshtë: Pra 3 pozicione ndihmës ligjor në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm dhe 3 pozicione ndihmës ligjor në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi***: Faleminderit zonja Etrita!

Ka diskutime?

Tashmë ju dëgjua zëri se herën e kaluar kishit një situatë teknike.

Ka?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votim.

***Irena Plaku***: Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Bledar Bajri***: Dakord.

***Albens Tabaku***: Pro.

***Markelian Koça***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Ilir Rusi***: I kërkoj administratës për efektivitet të bëjë njoftimet përkatëse të magjistratëve, me qëllim që ata të bëjnë përzgjedhjet e duhura, meqenëse dhe afati tashmë 24 orësh ka filluar dhe përfundon ditën e nesërme, ora 13:30.

Me shqyrtimin e kësaj pike, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbasdite të qetë.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**